



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kacanik**  
**Municipal Kacanik**  
**Kuvendi i Komunës**  
**-Kryesuesi i Kuvendit-**

**01Nr. 60/01-25025/22**  
**Kaçanik, 24.08.2022**

### **FTESË PËR MBLEDHJE**

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e VIII (tetë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2022.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 02 Shtator 2022 ( e Premte) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Kemal Murseli**

---

Në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të datës 02.09.2022, do të shqyrtohet ky:

### **REND PUNE**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e kuvendit të komunës;
2. Kërkesa e MBPZHR për Rishqyrtimin e Vendimit Paraprak 01Nr. 06-350/02-12630/2022 i datës 27.06.2022 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, në emër të Nexhmedin Elezi nga f. Sllatinë;
3. Kërkesa e MBPZHR për Rishqyrtimi e Vendimit 01Nr. 06-350/02-13415/22 i datës 27.06.2022 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në emër të Blerim Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër, nën qiramarrje 99 vjet;
4. Propozim Vendim për formimin e Komisionit të ankesave për procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kačanik  
Municipal of Kačanik

01Nr. 060/01-20610/22  
Kaçanik, 28.07.2022

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e VII (shtatë) e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2022 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 28 korrik 2022. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 26 anëtarë. Në mbledhje mungoj me arsye, Bashkim Luma.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Drejtorët e drejtorive: Qamil Stagova- DUKMM, Bahri Selimi-DBF, Sali Malsiu-DSHMS, Ramadush Osmani-DSHPE, Pranvera Loku-Zharku-DZHET, ndërkaq nga zyrtarët e komunës: Fatlume Guri-Selimi, Bejtulla Dalloshi, Kefsere Koxha. Nga OJQ, punimet e mbledhjes i përcolli 1 qytetar.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Telprezencës nga Gëzim Sahiti- zyrtar i lartë për monitorim të komunave në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit  
Procesmbajtës, Makfire Malsiu.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Kemal Murseli:** Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, prezentë janë 26 anëtarë, Bashkim Luma ka kërkuar me shtyrë mbledhjen për 1 ditë, me ka ardhur keq që nuk kam pasur mundësi pasi materiali i ka shkuar edhe MAPL, dhe në anën tjetër, kjo mund të bëhet praktikë nga anëtarët tjerë të KK. Kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, e hapi mbledhjen e VII (shtatë) të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2022, data 28 korrik, me këtë:

## REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e kuvendit të komunës;
2. Raporti Gjashtëmujor financiar për periudhën Janar – Qershor 2022;
3. Propozim Vendim për transferin e mjeteve;
4. Propozim Vendim Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim Afatgjatë;
5. Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
6. Propozim Vendim për formimin e Komisionit të ankesave për procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
7. Raporti i punës së KKSB për gjashtë mujorin e parë 2022;
8. Kërkesa e MBPZHR për Anulimin e Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore PK 00729-8 ZK Bob, në vendin e quajtur “Oborr”, arë e klasës gjashtë (6), pronë e Blerim (Ajeti) Çaka nga fshati Bob-Kaçanik.

Pika 8 është korrigjuar të Parcela kadastrale nga 000129-8 në 00729-8 me kërkesën e Agim Mani.

Lidhur me Rendin e propozuar të punës e hapi diskutim:

**z. Agim Mani:** Të pika 8. Kërkesa e MBPZHR për Anulimin e Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore PK 000129-8 ZK Bob, në vendin e quajtur “Oborr”, arë e klasës gjashte (6), pronë e Blerim (Ajeti) Çaka nga fshati Bob-Kaçanik, PK duhet të jetë: 00729-8

**Kryesuesi i Kuvendit:** Është një lëshim teknik që është bërë se vendimin që e kemi marrë është 00729-8. E përmirësojmë të rendi i punës, ndërkaq në material është në rregull. Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim me këtë ndryshim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

**APROVON**

**Rendin e punës në përbërje prej 8 pikave.**

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka lë të urdhëroj:

**z. Naim Beça:** Unë nuk kam vërejtje në procesverbal, vetëm mund të themi fjalë të mira për zyrtarin përgjegjës që e harton procesverbalin, në përmbledhjen e diskutimeve.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KK e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

**APROVON**

**Procesverbalin e mbledhjes së Kuvendit të Komunës (mbledhjes se 6 të rregullt), të datës 27.06.2022 / Lënda: 01Nr. 01Nr. 60/01-16843/22.** Procesverbali do të publikohet me disa korrigjime të vogla teknike.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kalojmë në pozicionin e pyetjeve dhe kërkesave;

### **Pyetje dhe Kërkesa**

**z. Adnan Reka:** E kam një pyetje për drejtorin e DSHPE, bëhet fjalë për pjesën e rrugës nga ‘Shtëpia e Kulturës’ deri te ‘Xhamia e Dëshmorëve’, ka vite që kjo pjesë e rrugës nuk ka ndriçim publik, dhe si e tillë shpesh është ngrit si çështje në këtë kuvend nga unë dhe disa kolegë të tjerë, por, asnjëherë nuk kemi marre përgjigje të saktë. Arsyet gjithnjë kanë qenë banale, njerëz të pandërgjegjshëm apo keqbërësit po i prishin. Ndërsa unë, po kërkoj t ‘na e thoni të vërtetën e kësaj pune: Pse nuk ka as lisa dekorativ e as ndriçim publik, sepse të dyja këto janë paguar, edhe për lisa edhe për ndriçim, ama as lisa, as ndriçim nuk kemi ? Vërtetë kjo është për keqardhje.

**z. Naim Beça:** Pozicioni pyetje dhe kërkesa, mua me duke absurde, se as në pyetje apo kërkesa nuk kemi marrë kurrfarë përgjigje. Nëse marrim përgjigje me shkrim të ndonjë kërkesë, realizim në praktikë nuk ndodhë. Ne jemi përfaqësues të komunitetit, kemi marrë vota me ardhur këtu, pavarësisht a jemi pozitë apo opozitë, nuk po e shoh të arsyeshme këtë pozicion, sepse komuna jonë nuk po i realizon pyetjet dhe kërkesat që i kemi ngritur. Ka kërkesa që i kam ngritur, si çështja e shkallëve, me një buxhet të vogël ishin rregulluar, se ka pasur raste që janë rrëzuar fëmijët. Gropa të Ura Hazirit ende nuk është rregulluar. Tre herë kam kërkuar me u rregulluar, kam pasur edhe kërkesa tjera të cilat me pak mjete ishin realizuar. Atëherë pse me qenë ky pozicion vetëm për procedurë, nuk ka nevojë me qenë, vazhdoni kështu, unë kam shumë kërkesa që mundem me i ngritur, por për derisa nuk realizohen ato që i kemi ngritur, nuk e shoh të arsyeshme me ngritur të tjera.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Faleminderit Naim, megjithatë shfrytëzoni të drejtën e juaj ligjore me i drejtuar ekzekutivitet me i ngritur shqetësimet e qytetarëve, ndërkaq për realizimin e tyre është në përgjegjësi të ekzekutivitet varësisht nga nevojat dhe mundësitë që i kanë me u përgjigje në pyetje dhe kërkesa.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Pajtohem me z. Naim Beça se përgjigjet nuk i kemi marrë me kohë, rast konkret është të një pyetje të cilën e kam bërë para 2 mbledhjeve; Ku ka mbetur çështja e themelimit të Muzeut historik ? Me siguri kërkesa e iniciativës qytetare ka mbetur në sirtarë të organit përgjegjës, se u deshën 2 muaj me marrë përgjigje. Ne jemi në KK të votuar që me i marrë ankesat e qytetarëve me i ngritur këtu, ndërkaq drejtorët dhe ekzekutivitet janë të emëruar për me na i kthyer përgjigjet.

**znj. Ardita Rrahmani:** E ngriti shqetësimin për çështjen e një vendimi të qeverisë për mbylljen e lokaleve në ora 24:00. Unë po flas në emër të disa lokaleve të gastronomisë që veprojnë në Kaçanik, ku ekzekutivitet i atij vendimi po bëhet pjesërisht, për faktin se disa lokale po mbyllen. Kjo ndoshta është një pyetje e cila duhet me i drejtuar shtabit emergjent, gjithsesi po e paraqes fillimisht këtu, se ka lokale që veprojnë edhe pas orës 24: 00. E di që policia merr masa për mbylljen e lokaleve, ndërkaq inspektorët janë ata të cilët i ekzekutojnë gjambat e shqiptuara me mjete financiare. Në emër të disa lokale, po e përsëris edhe një herë, kjo nuk është e drejtë, se po bëhet ndarje selektive në gjobitjen e këtyre lokaleve. Kërkoj nga kryetari i komunës nga ekzekutivitet të merr masa ndaj inspektorëve, se paku t’iu tërhiqet vërejtje që mos të jenë të njëanshëm. Për cilët inspektorë është fjala, nuk do të flas me emra.

**z. Betim Shala:** Kërkesë për drejtorin e DUKMM; Tani veç është nënshkruar kontrata për rrugët lokale. Rruga “Sylejman Kuka ”është rrugë në zonën e I në Kaçanik në të cilën rrugë nuk mundet me jetuar prej kundërmimit të erës së kanalizimit, rruga ka 118m<sup>2</sup>, dhe segmenti 35 m<sup>2</sup>. Kërkoj që kjo rrugë me futur në prioritet të projekteve të ndërtimit të rrugëve lokale.

**z. Agim Çaka:** Diskutimi im ndërlidhet me diskutimin e kolegëve paraprak, Naimit dhe Kadrijës, për pyetjet të cilat i kemi ngritur se nuk kemi përgjigje, kjo është shqetësuese. Nuk është problemi a rregullohen a jo, por është në obligim ligjor të organeve kompetente me kthyer përgjigje se a realizohen a jo. Unë kam ngritur; çështjen e mbeturinave, kullën e Hasanit, zërimin, mirëpo përgjigje nuk ka. Nuk ka përgjigje sa kushton zërimin për 1 vit. Nuk është me rëndësi kujt i paguhet, me rëndësi është me ditur çmimin, pastaj ne vendosim se a me pasur zërim apo jo. Çështja e sigurisë në shkollë, është mirë me kthyer përgjigje me shkrim për këtë dhe për pyetjet dhe kërkesat tjera të cilat i ngritëm, se kjo çështje është e përcaktuar edhe me rregullore.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Pyetje dhe Kërkesa tjera nuk kemi, ekzekutivitet i ka parasysh çështjet të cilat u ngritën, besoj se kanë më kthyer përgjigje. Kalojmë në pikën vijuese:

## 2. Raporti Gjashtëmujor financiar për periudhën Janar – Qershor 2022;

E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Të raporti financiar është një informatë për objektivat e grumbullimit të mjeteve të planifikuara dhe shpenzimin e tyre sipas kategorive të përcaktuara buxhetore. Me këtë rast e kemi raportin gjashtëmujor janar-qershor. Nga buxheti i miratuar në shumë 9,193,167.00€ dhe mjetet e bartura nga viti 2021, në shumë prej 706, 271.35€, buxheti ka arritur në total 9,899,430.35 €. Nga ky buxhet është mirë të planifikohet e realizohet në përputhshmëri me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve. Përveç granteve qeveritare, kemi planifikuar realizimin e të HVK në shumë 689,430,00 €. Në vend që të inkasohen deri me tani 50% e mjeteve të

planifikuara, ju keni realizuar vetëm 31.76% apo 218,966.20 €. Përpos inkasimit të dobët, keni mungesë të raportit tabelar që identifikon të hyrat nga programet buxhetore. Njëjtë ka shkuar edhe dinamika e shpenzimeve, ashtu që për periudhën raportuese gjashtëmujore janë shpenzuar 3,050,305,46 € apo 30.31%, duke marrë parasysh që në këtë shumë hynë pagat dhe mëditjet 47.62%, mallrat e shërbimet 33.71%, shpenzimet komunale 16.42%, subvencionet dhe transferet 39.04%, shpenzimet kapitale 2.13%. Unë si shef i GP të LVV shprehi shqetësimin për realizimin e ulët të buxhetit të komunës për Investime kapitale (IK). Sipas raportit gjashtëmujor financiar të komunës së Kaçanikut janar-qershor 2022 ekzekutivi i komunës respektivisht kryetari i komunës ka arritur t'i shpenzoj vetëm 2% të buxhetit të planifikuar për IK, ndërkaq dihet se IK janë parakusht për zhvillimin e vendit, duke u bazuar në nevojat reale të qytetarëve për të përmirësuar kualitetin e shërbimeve dhe jetën e qytetarëve të komunës tonë. Ky trend i shpenzimeve të buxhetit për IK dëshmon edhe njëherë paaftësinë e komunës për të planifikuar dhe realizuar projektet kapitale brenda vitit buxhetor. Ky shpenzim vetëm me 2% është një tregues i qartë i paaftësisë së angazhimit dhe mungesës së angazhimit sistematik të kësaj qeverie për të menaxhuar dhe mbikëqyrë buxhetin.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Të raporti i inkasimit të HVK, shihet se jeni larg përmbushjes së objektivave të projektuara në vitin 2022, tashmë kur jemi në pjesën e tretë të vitit 2022. A keni shpjegime për këtë? Gjithashtu keni theksuar se keni problem me raportet bankare të pranuar dhe nuk mundur t'i paraqitni raportet sipas llojeve të hyrave nëpër drejtori. A është problem me bankat komerciale apo me bankën qendrore, pasi që nga përvoja ime në banka, pagesat ekzekutohen në baza ditore dhe bankat komerciale janë të obliguara që tranferet t'i realizojnë në pajtim me afatet ligjore të përcaktuara nga banka qendrore që nuk janë më të gjata se ditore ose vikendeve apo festave në ditët pasuese të punës. Prandaj, mendoj së arsyetimi i dhënë nuk qëndron.

**z. Bahri Selimi:** Me shumë u komentuar raporti gjashtëmujor, përqindjet që janë paraqitur në raport janë këto që janë. Të raporti i të HVK unë rastësisht e kam përmendur që nuk e kemi raportin gjashtëmujor të inkasimit të tyre. Ne kemi pasur problem me regjistrim të hyrave e jo me bankat. Raporti na ka ardhur nga banka, ne kemi pasur problem me mungesën e zyrtarit, ky është problem teknik që zgjidhet. Ju garantoj se raporti gjashtëmujor i të HVK është përgatitur, ua përcjelli si raport të veçantë. Përqindjet e realizimit që e potencoj Agimi, është raport 6 mujor. Të investimet kapitale është ajo përqindje, me tepër kemi qenë në fazën e përgatitjes së inicimit të projekteve kapitale për lidhje të kontratave. Dallimi në mes këtij viti me vitin e kaluar, në vitin e kaluar në këtë periudhë janë paguar disa borgje të IK, por jo krejt, megjithatë ka pasur progres viti i kaluar diku 300,000.00 €, në raport me këtë periudhë. Ecuria e projekteve kapitale është duke shkuar mirë, të raporti janar-shtator do të keni një pasqyrë me të mirë të IK.

**z. Adnan Reka:** Derisa kemi Raporte financiare për te cilat Zyra Kombëtare e Auditimit konstaton se janë në sh përputhje me Rregullën financiare 01/2017 dhe thotë se janë të pa sakta, atëherë, çfarë te themi ne? Te diskutojmë për formën apo për përmbajtjen? Për formën, edhe mund te diskutojmë se, a është e mirë apo e keqe, dhe mund te themi që nuk është e mirë. Ndërsa sa i përket përmbajtjes, vërtetë nuk kemi çfarë diskutojmë, për shkak se auditori ka konstatuar se Raporti financiar është i pa saktë dhe në s'përputhje me ligjin. Çfarëdo që ne diskutojmë rreth përmbajtjes nuk e themi dot më mirë se Auditori, sepse as nuk jemi me kompetent e as nuk kemi mundësi!

**z. Bahri Selimi:** Adnan, ti po i referohesh Raportit të auditorit për pasqyrat financiare të vitit të kaluar e jo të këtij viti, se kjo është pasqyrë financiare për janar qershor 2022. Nuk është e vërtetë aspak. Raporti i auditorit thotë: Pasqyrat financiare të Komunës së Kaçanikut të vitit 2022 janë të vërteta dhe të sinqerta. Kur të duash të dërgoj kopjen e faqes konkrete ku shkruan,

se nuk e paske lexuar mirë. Raportet të cilat ne i kemi dërguar deri me 31 janar është e vërtetë se të gjitha komunat mund të bëjnë ndonjë gabim teknik-lëshim, kryesisht nga mosbarazimet e komunës dhe njësisë së kontabilitetit në thesar. Nganjëherë thesari i regjistron disa të hyra ose shpenzime gabim, i përzien organizatat buxhetore, por kur ti konsolidon i saktëson dhe na i dërgon neve dhe na lejon njëfarë korigjimi, na thotë, deri me 28 shkurt mundeni me bërë përmirësime. Ne, i kemi bërë përmirësimet, ndërkaq ai e ka përmendur se deri 31 janar kur janë dorëzuar nuk kanë qenë bash të sakët, mirëpo në fund janë të sakta. Unë edhe ti tani i diskutojmë, mundesh me ardhur në zyre, raporti është publik, auditori ka shkruar se pasqyrat financiare janë të sigjerta dhe të sakta.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ne, raportin e auditorit e kemi shqyrtuar në KK, secili që ka dashur e ka dhënë mendimin e tij, kështu që mos të dalim nga rendi i ditës. Nëse në këtë raport ka të dhëna të pasakta, atëherë duhesh me na treguar Adnan se cilat të dhëna nuk janë të sakta.

**z. Bahri Selimi:** Jo vetëm Adnani, por kushdo qoftë që ka të dhëna për keqpërdorimin e parasë publike për periudhën janar –qershor të buxhetit 2022, të ngrit shqetësimin.

**z. Adnan Reka:** Unë thash se ne as nuk jemi kompetent dhe as nuk dimë më mirë se auditori, ndaj të cilit keni obligim për çfarëdo dokumenti që iu kërkon, me ia ofruar. Raporti financiar sa i përket përmbajtjes, nuk kemi çka të themi, derisa auditori thotë se Raporti financiar është i pa saktë

**Kryesuesi i Kuvendit:** Adnan mos i përziej gjërat, për këtë raport prit kur të jep auditori vlerësimin e vet se nuk e ka dhënë ende. Raporti i auditorit ka qenë për pasqyrat financiare të vitit 2021, janë debatuar këtu në KK edhe të gjeturat edhe shkeljet, mangësitë edhe ato që kanë qenë pozitive. Këtë raport nuk e ka shikuar auditori ende, kur të shikon, atëherë e jep vlerësimin dhe bazohemi në vlerësimet e auditorit. Mos na kthe prapa tani.

**z. Adnan Reka:** Unë nuk po iu kthej prapa hiq, e kam të drejtën e fjalës. Derisa auditori konstaton se ju nuk iu përmbaheni rregullave financiare, dhe është i pasaktë raporti, atëherë përmbajtja e raportit është për t’u dëshiruar.

**z. Bahri Selimi:** Nuk është e vërtetë Adnan.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, Raporti financiar kalon si informatë se nuk votohet, kështu që konstatohet se Kuvendi i komunës u,

## NJOFTUA

**Me Raportin gjashtëmuor financiar për periudhën janar – qershor 2022 / Lënda: 01Nr. 104/02-20242/22.**

### 3. Propozim Vendim për transferin e mjeteve;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Drejtori është këtu, kjo pikë është debatuar edhe në KPF, janë sqaruar mundësitë e transferit të mjeteve. E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Të ky transfer i mjeteve besoj se keni të drejtë ligjërish, mirëpo ka qenë një keq planifikim i juaj, ku thuhet: Transferi i këtyre mjeteve kërkohet të teprica e mjeteve të projekti i ndërtimit dhe rregullimit të çarshisë së vjetër të qytetit. Ky projekt ende është në procedurë të punimeve, ndërkaq ju po doni me ia tërheq mjetet ende pa u kryer projekti. Ne e dimë që në secilin projekt mund të devijoj projekti. Kjo është një keq planifikim që nuk keni munduar me ia qëlluar për 25,000.00 € për një projekt, ndërkaq në anën tjetër thoni se ka mungesë të mjeteve të kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

**z. Bahri Selimi:** Detyrë e jona është me ekzekutuar buxhetin sa me afër 100%. Ju e thatë se ligjërisht lejohet transferi i mjeteve, por ligjërisht lejohet edhe rishikimi i buxhetit, kjo është procedurë e rregullt që ndodhë në krejt komunat dhe ministritë, ndërkaq që 5-6 viteve nuk është duke u bërë rishikim i buxhetit. Me pas pasur rishikim të buxhetit, unë kisha tërhequr me tepër mjete të ky projekt, që po e quani keq planifikim, por po i tërheq vetëm 25,000.00 € se deri 15% me lejon ligji, por këtu i kam tërhequr 14.71% të GQ. Kontrata e lidhur për këtë projekt është se nuk po i tërheqim mjetet pa u realizuar projekti, kontrata i specifikon të gjitha. Nuk ka nevojë me prituri muajin dhjetor sesa mjete po mbesin, por i planifikoj suficitin e mundshëm, se atë detyrë e kemi. Kontrata e arritur me operatorin ekonomik për realizimin e këtij projekti është 291,761.19€, e lidhur në fund të muajit gusht 2021. Kontrata është 2 vjeçare, përfshinë buxhetin e 2 viteve, 2021-2022. Shpenzimi aktual i këtij projekti është 160, 867.50 €. Sivjet i kemi 200,000.00 € për këtë projekt, edhe 130,893.50 € kanë me u shpenzuar, 69,106.50 € mbesin nga ky projekt. Të kjo shumë,30.000€ janë nga të HVK, ndërkaq tjerat janë GQ, andaj si ekspertë të kësaj fushe e kemi shfrytëzuar të drejtën ligjore, ku 15% të ndarjes buxhetore nga GQ të ky projekt. Nja 15.000 € që janë GQ se i kisha tërhequr edhe ato, por nuk me lejon ligji mbi 15%, minus 25,000 € të ky projekt, mbesin 44,165,50 €. Nuk d.m.th. që çdo projekt me pasur devijime. Ky projekt është mirë i analizuar.

**z. Agim Mani:** Për këtë projekt po i bien që shuma 44,165.50 € kanë qenë të keq planifikuara.

**z. Bahri Selimi:** Ne planifikojmë, pastaj me vonë lidhet kontrata. Të ky projekt ka kursim. Është mirë me u sqaruar paraprakisht me ndonjë zyrtar financiar në partinë e juaj nëse keni, se me të vërtetë po dilni keq.

**z. Qamil Stagova:** Arsye pse kanë ngelur mjete nga projekti i çarshisë së vjetër, është se duhet me u bërë dislokimi i trafos, ndërkaq neve nuk na ka dhënë përgjigje KEDS a i marrin përsipër kabllo etj. se ata shpesh herë dinë që komplet shpenzimet me na i ngarkuar. Për këtë arsye nuk i kemi tërhequr komplet mjetet nga ky projekt, se e dimë që përveç vlerës së kontratës, mundet me shkuar edhe për 10% më tepër shuma e mjeteve për projektin.

**z. Adnan Reka:** Punët janë shumë keq në çarshinë e vjetër, krejt e dimë. Kockat në këtë rrugë kanë dalë përjashta ende pa u kryer projekti. Prandaj ia keni dhënë projektin kompanisë me çmim jashtëzakonisht me të ulët, por punët me i kryer si të donë. Punët janë shumë keq se ju i jepni tenderët ofertës me çmim me të lirë.

**z. Bahri Selimi:** Ligji e jep me ia dhënë tenderit ofertës me çmim me të lirë.

**z. Adnan Reka:** Jo, nuk e jep ligji, ekspertët tonë nuk na kanë thënë se projekti i jepet firmës me çmim me të lirë. Projekti ka detaje qysh me kryer punët e jo me u kryer punët qysh duash. Projektin ia keni dhënë kompanisë me çmim me të lirë, kujt keni dashur, ndërkaq punët kanë ngelur pa u kryer.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Mos e shndërroni debatin në bashkëbisedim se kush është më i dijshtëm apo i padijshtëm se tjetri. Ajo që duhet të diskutohet është se, ata që e kanë dhënë mundësinë e bartjes se mjeteve, besoj se kanë qenë me ekspertë, nuk e kemi bërë ne, por ekspertë me të lartë se ne. Bartja e mjeteve ndodhë në secilën komunë, ndodhë që lidhen kontrata me të lira sesa kushton projekti dhe mjetet e ngelura barten. Të ky projekt, është bërë parashikimi, është lidhur kontrata, jam me ty Adnan që me u mbikëqyrë kontrata deri në fund që me u kryer punimet si duhet, ndërkaq mjetet e ngelura nuk bënë të na kthehen në suficit, por duhet me i destinuar aty ku ka nevojë.

**z. Adnan Reka:** Ne po pajtohemi që ofertuesi me i lirë ligjërisht duhet me ia dhënë kontratën, por jo me ia dhënë kontratën pa kurrfarë obligimesh, se rezultatet po shihen me mirë në terren.



**z. Bahri Selimi:** Duke punuar kështu Komuna e Kaçanikut edhe në vitet tjera kemi arritur me shpenzuar GQ mbi 99%. Jemi ekspertë, kështu që mos na kritikoni pse po e respektojmë ligjin.

**z. Agim Çaka:** Çështjet profesionale, ekonomike nuk është në obligim të anëtarëve të KK me i ditur terminologjitë dhe mënyrën sesi shpjegohen. Për atë arsye janë drejtorët, ekspertët këtu me na i shpjeguar në mënyrë me popullore që ne me i kuptuar, se ka gjera që në aspektin profesional nuk mund t'i kuptojmë mirë. Transferi i mjeteve është i paraparë me ligj, për ne është në rregull. Ajo që na intereson ne është shuma e transferit, a është brenda normave të lejuara të kornizës ligjore dhe siç u tha është brenda normave? Edhe arsyetimi duhet me qenë i logjikshëm i drejtë dhe bindës pse po bëhet ky transfer.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 19 votë Për, 7 votë Kundër, Abstenim nuk ka. Pjesëmarrës në votim 26. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për transferin e mjeteve e mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale (fondi 10), Nga nën-programi: Planifikimi urban dhe inspeksioni 66445, shuma 25,000.00€, Transferohen në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbime (fondi 10), Në nën programin: Planifikimi urban dhe inspeksioni 66445, shuma 25,000.00€ /Lënda: 01Nr. 104/02-20260/22.**

**4. Propozim Vendim Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim Afatgjatë;**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në vitin e kaluar KK e ka marrë një vendim për pronat e komunës të cilat do të epën në shfrytëzim në vitin 2022, d.m.th është bërë lista paraprake, ndërkaq tani janë specifikuar disa prona nga lista që do të epën në shfrytëzim. Drejtori është prezent në mbledhje, e hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Të ky propozim vendim, unë jam i mendimit që mos të epën në shfrytëzim pronat komunale në afat të gjatë kohor, por afatmesme, varësisht nga kërkesat dhe interesat për zhvillimin e bizneseve, krijimin e mundësive për punësimin e qytetarëve të komunës. Të këto prona, përpos listës të tyre që u përmend, është mirë të definohet parcelimi i saktë i tyre, që bizneset që i marrin në shfrytëzim pronat e komunës, mos të hasin në vështirësi. Nëse e shihni në gjeoportali, disa parcela kanë probleme me rrugë, shtëpi banimi. Është dashur që për secilën parcelë të kemi edhe skicën, që të dimë se çka po votojmë. Të parcela 01866-0 rruga "Dëshmorët e Kombit", shembull konkret po e marrë, A keni me ia prishur shtëpinë, a keni me mbyllur rrugën apo çka keni me bërë, që ne të dimë se çka po votojmë, por edhe ai që e merr në shfrytëzim pronën, mos të kenë probleme në të ardhmen, sikurse ka pasur raste me herët. Janë edhe parcela tjera që ndajnë rrugë, por kjo që e potencova, shihet se paraqet pengesë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Të pika 2.4, të PK nr. 00156-2 me kulturë kullosë e klasës 4 në sipërfaqe gati 1.5 ha, ZK Koxhaj, e di që ka pasur kërkesë të banorëve të asaj zone për sigurimin e një lokacioni për varreza për atë pjesë. Meqë nuk ka pronë tjetër komunale në atë zonë, kërkoj nga drejtorja dhe KK që të përcaktohen që 0.5 ha të kësaj parcele të ndahet, mos të epët në shfrytëzim, pasi është nevojë emergjente e asaj zone për një lokacion për varreza.

**z. Agim Mani:** Parcelat fillimisht duhet me i parcelua, pastaj me i dhënë në shfrytëzim, për shkak se, nëse e jep pronën në shfrytëzim aty ku ka shtëpi banimi, atëherë duhet me ia prishur shtëpinë personit.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Sido që të jetë edhe komisioni i trajton këto çështje, e bënë klasifikimin aty ku ka rrugë etj. që mos me hyrë rruga në proces të dhënies në shfrytëzim të pronës.

**z. Agim Çaka:** Të çështja e dhënies në shfrytëzim të pronave komunale në periudhë kohore afatgjatë, edhe unë jam i pajtimit me shqyrtuar mundësinë me i dhënë në shfrytëzim afatmesëm, se periudha 99 vjet është kohë e gjatë. KK deri tani ka dhënë prona komunale në afat të gjatë kohor. A ka ndonjë raport të hartuar për ato prona që janë dhënë në shfrytëzim, ku janë me dinamikë të investimeve, si ka shkuar kjo punë, në mënyrë që të kemi një bazë për pronat të cilat janë dhënë në shfrytëzim, a kanë pasur efekt apo jo, a kanë punuar njerëzit dhe ku kanë arritur? Është mirë ne me ditur saktë se çka planifikohet me u investuar, me u siguruar ana ligjore, ashtu që pronat e komunës fillimisht me u shpallë (me u bërë publike) për me u dhënë në shfrytëzim afatgjatë, se nuk vjen askush me investuar, pa e ditur se një pronë e komunës është duke u dhënë në shfrytëzim në afat të shkurtër apo të gjatë kohor. Kjo që kërkova për ato prona që janë dhënë me herët, ishte që të dimë për hapat e mëtejme se a jemi duke gabuar në hapa apo jo. Nëse prona është e komunës, edhe nëse ka shtëpi apo investim biznesi, dihet se komuna pronën e vet e shfrytëzon ashtu si donë vet.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ne po marrim vendim me hapur rrugë me iu ndihmuar njerëzve me aplikuar me projekte në këto prona të caktuara që po i diskutojmë sot. Pas këtij vendimi, do të formohet komisioni i ankesave i cili ka me i trajtuar këto kërkesa përmes ankandit publik. Nuk d.m.th. që ne sot me i dhënë në shfrytëzim. Ne mund të mos i japim sivjet hiq, por nëse ka ndonjë investitor serioz që mendojmë se investon, investitor që kanë ndonjë projekt të mirë për me realizuar në këto parcela, atëherë pse jo. Pas kësaj, komisioni ka me i udhëhequr procedurat sipas ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale dhe rregullores, e bënë vlerësimin dhe na i sjellë rekomandimet në kuvend. KK e ka fjalën përfundimtare. KK duhet me i pasur të gjitha materialet dhe me shqyrtuar se a ka arsye për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të këtyre parcelave apo jo.

**z. Adnan Reka:** Rikujtim, A nuk ishte kjo parcelë 01866 që para 2-3 viteve krenoheshim në KK se e kemi bërë një terren sportiv. E njëjta parcelë sot propozohet me u dhënë në shfrytëzim. A nuk bënë këto hapësirat publike me mbetur për interesa publike me iu shërbyer qytetarëve të lagjes? Unë jam kundër kësaj logjike dhe kundër dhënies në shfrytëzim të kësaj prone.

**z. Qamil Stagova:** Dhënia në shfrytëzim e pronës komunale nuk parasheh në asnjë mënyrë që me humbur atë terren sportiv. Për statusin e kësaj shtëpie të cilën e tha Agimi, do të shohim se qysh iu ka dhënë në shfrytëzim. Për rrugën e cila u përmend të “Dëshmorët e Kombit”, mos të flasim fare, sepse nuk ka me u dhënë në shfrytëzim rruga.

**z. Agim Mani:** Në këtë parcelë është edhe rruga “Dëshmorët e Kombit”, kjo i sjell probleme investitorëve.

**z. Adnan Reka:** Unë nuk fola për rrugën por për terrenin sportiv, se ju doni me i prishur e me ia dhënë dikujt në shfrytëzim për 99 vjet.

**z. Qamil Stagova:** Unë u ndërlidha edhe me diskutimin e Agimit, Unë nuk e di a epët në ankand, mund të ndodhë, ne nuk kemi hyrë me bërë ndryshime pa u dhënë në shfrytëzim. Do të shohim si shkon puna, normal nuk kemi me dhënë në shfrytëzim terrenet sportive.

**z. Adnan Reka:** Nëse nuk i jep në shfrytëzim terrenin sportiv, atëherë pse nuk e ke ndarë, mos me proceduar në ankand publik fare, se nuk ka kuptim me votuar pa u ndarë kjo e terrenit sportiv. Ndaje fillimisht pjesën që ke me dhënë në shfrytëzim, pastaj ne e votojmë ose nuk e votojmë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim propozim vendimin e DUKMM me kërkesën që e bëra unë që të pika 2.4, sipërfaqja prej 0.50 ha të mos jepet në

shfrytëzim në ZK në Koxhaj, 14 Për, Kundër 7, Abstenim 5. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i komunës mori këtë:

#### VENDIM PARAPRAK

**Për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim Afatgjatë**

**Njësia Kadastrale me nr.00293-0, me kulturë kullosë e klasës 3, me sipërfaqe prej 03.49.00 ha, zona kadastrale Duraj.**

**Njësia Kadastrale me nr.01866-0, me kulturë livadh i klasës 5, me sipërfaqe prej 00.68.68 ha, zona kadastrale Kaçanik.**

**Njësia Kadastrale me nr.00232-0, me kulturë kullosë e klasës 4, me sipërfaqe prej 02.01.36 ha, zona kadastrale Kotlinë.**

**Njësia Kadastrale me nr.00156-2, me kulturë kullosë e klasës 4, me sipërfaqe prej 01.49.74 ha, zona kadastrale Koxhaj, jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 1,00,00 ha (1 hektarë) / Lënda: 01Nr. 104/02-20245/22.**

5. Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, 2 nga KK, 2 nga ekzekutivi, 1 nga OJQ. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, shkojmë me propozime konkrete, sipas rregullit nga subjektet politike me të mëdha.

**znj. Fitore Vishi:** Nga PDK e propozojmë për anëtare të komisionit, Florina Lika-Vishi.

**z. Agim Mani:** Nga LVV e propozojmë për anëtare të komisionit, Ernesta Krasniqi.

**z. Qamil Stagova:** Nga Ekzekutivi për anëtarë të komisionit propozojmë të jenë: 1. Besmir Krasniqi dhe 2. Mentor Shehu.

**Kryetari i Komunës:** Nga OJQ, anëtar i këtij komisioni do të jetë, Remzi Reka.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Propozimet që dolën i shtroj në votim për aprovim dhe të njëjtit u aprovuan me 22 votë Për, Kundër votë nuk pati, abstenuan 4 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për formimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, në përbërje;**

- |                              |               |   |
|------------------------------|---------------|---|
| <b>1. Besmir Krasniqi</b>    | <b>anëtar</b> | <b>(Ekzekutivi);</b>                                    |
| <b>2. Mentor Shehu</b>       | <b>anëtar</b> | <b>(Ekzekutivi);</b>                                    |
| <b>3. Florina Lika-Vishi</b> | <b>anëtar</b> | <b>(Kuvendi- PDK);</b>                                  |
| <b>4. Ernesta Krasniqi</b>   | <b>anëtar</b> | <b>(Kuvendi-LVV);</b>                                   |
| <b>5. Remzi Reka</b>         | <b>anëtar</b> | <b>(Shoqëria Civile) / Lënda: 01Nr.104/02-19959/22.</b> |

6. Propozim Vendim për formimin e Komisionit të ankesave për procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, 2 nga KK, 2 nga ekzekutivi, 1 nga OJQ. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, shkojmë me propozime konkrete, sipas rregullit nga subjektet politike me të mëdha; PDK dhe AAK.

**znj. Fitore Vishi:** Nga PDK për anëtar të komisionit e propozojmë të jetë: Brahim Imishti.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Nga LVV për anëtar të komisionit e propozojmë të jetë: Adnan Reka.

**z. Qamil Stagova:** Nga Ekzekutivi për anëtarë të komisionit i propozojmë të jenë: 1. Zekir Selimi dhe 2. Fadil Guri.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nga OJQ, e presim propozimin, pasi që nuk e kanë dërguar ende emrin. A jeni të procedojmë me votim pa emrin e anëtarit nga OJQ.

**z. Adnan Reka:** A kemi të drejtë me votuar diçka që nuk e dimë pa e pasur emrin ? Për derisa nuk e kemi emrin e një anëtari nga OJQ, unë jam që këtë çështje me shtyrë për mbledhjen tjetër apo të lëmë për në fund të mbledhjes.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kryetar, a keni kontakt me OJQ që të marrim një emër për anëtar të këtij komisioni?

**Kryetari i Komunës:** Jemi duke pasur problem në këtë drejtim, pasi OJQ nuk kanë kryetar dhe OJQ-të nuk po kanë kujt me u drejtuar.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Meqë komisioni për ankesa ka procedura, deri sa të përfundon punën komisioni vlerësues ka kohë, atëherë e shtyjmë për mbledhjen vijuese këtë pikë.

**z. Rustem Zenuni:** Si do të veprojmë nëse në seancën e radhës nuk kemi përsëri përfaqësim nga OJQ në këtë komision, atëherë ne nuk mund të mbetemi peng i një emri, se është problem me gjetur anëtar nga OJQ. Unë kërkoj që formimi i këtij komisioni të votohet në këtë mbledhje.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në seancën e radhës besoj se do të gjendet ndonjë përfaqësim nga OJQ në këtë komision. A jeni që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen vijuese? Për ish-in 23 anëtarë, Kundër ish-in 2 anëtarë, Abstenim nuk ka. Në votim morën pjesë 25 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi se, **Kuvendi i Komunës vendosi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen vijuese.**

7. Raporti i punës së KKSBB për gjashtë mujorin e parë 2022;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Në këtë raport pune nuk e vërejtja se është diskutuar në asnjë mbledhje të këtij këshilli, çështja e aksidenteve që po ndodhin në hyrje të autostradës të varrezave të dëshmorëve, të cilat aksidente po na kushtojnë me jetë të qytetarëve. Këtë çështje e kam ngritur edhe në mbledhje të KPF. Kërkesa ime është që të ketë patrulla të policisë rregullisht në atë pjesë, të vendoset një shenjë sinjalizuese për kujdes shpejtësinë. Respektimi i orarit të kujdestarisë së barnatoreve që shërbejnë në qytet, këto tema janë të lidhura direkt me shëndetin dhe jetën e qytetarit, të dyja kërkojmë vëmendje nga të gjithë ne. Prandaj iu rekomandoj me i pasur parasysh këto çështje, mos të vihen vetëm si rekomandime, por të veprohet në këtë drejtim.

**z. Naim Beça:** Në KKSBB e kemi diskutuar dhe kam bërë disa pyetje para dy mbledhjeve të KK çështjen e sigurisë në komunën tonë, nuk ka ndonjë përgjigje. Unë i kam tre procesverbale të mbledhjeve të këtij këshilli që janë mbajtur në vitin 2022. Çështjet të cilat janë diskutuar, mundem me thënë se nuk kanë thënë asgjë. Unë kam qenë përkthyes mbi 11 vjet në shumë komuna të Kosovës dhe e di shumë mirë se qysh shkon procedura në KKSBB. Në mbledhjen e parë ka marrë pjesë komandanti i policisë, ndërkaq në mbledhjen e dytë ka marrë pjesë një rreshter. A është legjitim ai me përfaqësuar pjesën e sigurisë së komunës? Në mbledhjen e tretë po e shoh procesverbalin, por po e shoh raportin e kryetarit të komunës. Faleminderit që i ke shprehur shqetësimet tuaja kryetar për përdorimin e narkotikëve të grup moshave të reja, por nuk po e shoh përgjigje që të kanë dhënë. Kanë kaluar 6 muaj të këtij viti, janë 56 raste për vepra penale, shumica prej tyre janë raste shumë të vogla, si vjedhje -nuk janë të vogla mos me keqkuptoni, por po e themi decidivisht, vjedhje e rëndë, prerje pylli, kurse çështjet madhore që

e shqetëson këtë komunë, mund të themi edhe kombin tonë, nuk është përmendur asnjë fjalë. Është diskutuar me shumë 1-2 orë për qentë, ndërkaq nuk është folur asnjë minutë për njerëzit, për çështje që kanë pasoja, kur dihet se të rinjtë janë duke konsumuar alkohol, drogë, janë duke bërë gjëra të këqija, d.m.th. në mbledhjen e parë është shfaqur ky shqetësim, në mbledhjen e dytë asgjë, kalon kjo çështje, pas tre muajve tjerë asgjë, përsëri debatohet për; qentë, dru, komunikacion e ka parkuar keq se ka parkuar keq veturën, ndërkaq thelbi i asaj që duhet debatuar nuk përmendet askund. Në mbledhje kur kam qenë unë përkthyes kanë marrë pjesë FSK, KFOR, shërbimi inteligjent i atij stacioni, komandanti i stacionit dhe pjesëmarrës tjerë relevantë. Në bazë të procesverbalit, nuk ka kurrfarë diskutimi, sa persona janë arrestuar për përdorim narkotikëve- kontrabandë narkotikëve, të cilat janë vepra janë shumë të rënda. Për vrasjet nuk përmendet asgjë, ndërkaq ka pasur raste të vrasjeve të varrezat e dëshmorëve, është përmend vetëm sipërfaqësisht, ndërkaq me tepër është folur për qentë endacak sesa për njerëzit që janë vlera për kombin tonë. Nuk e di tjetër se çka keni diskutuar, janë thënë unë e propozoj këtë apo atë, parkingjet, policia nuk është për me dënuar. Shqetësimi i jonë dhe i qytetarëve dhe i krejt juve, është narkotiku që në komunën tonë shumë i theksuar. Jam dëshmitarë i asaj se për çdo natë shoh në korzo duke konsumuar substanca narkotike nga djemtë e rinjë. Si doni sonte dalim në shëtitore dhe i shohim, populli i sheh. Asnjë arrestim nuk ka. Kamerat e sigurisë nuk funksionojnë në komunën tonë, staf nuk ka policia e jonë në komunën tonë, pasisë terreni është kodrinore malor dhe nuk është i mjaftueshëm. Ç farë sigurie kemi ne, asgjë, kamerat tani i ka marrë në menaxhim ministria, por të paktën duhet me iu bërë presion. Komandanti i stacionit duhet me ardhur në mbledhje, shefi i inteligjencës, me raportuar në mënyrë pak më normale, e jo me folur për shenjat e trafikut, edhe kjo është probleme por probleme me madhore janë narkotikët; droga, alkooli, e jo qentë nuk janë problem madhor. z. kryetar kërkoj t 'na bënë një pasqyrë me reale të gjendjes së sigurisë, sepse nga procesverbali nuk po shoh se është bërë.

**znj. Fitore Vishi:** Për shkak të mirësjelljes dhe respektit zoti Beça, kryetarit mendoj se duhet me iu drejtuar me “ju” e jo me “ti” .

**znj. Fitore Vishi:** Në rregull.

**z. Naim Beça:** Edhe ti Fitore, duhesh t' më drejtohesh mua herëve tjera me ‘zotëri’.

**znj. Ardita Rrahmani:** Atëherë me diskutuar me parafolësen, pa dashur me i dalë në krah apo me i hyrë në hak askujt, shprehjet të cilat përdoren këtu në KK, e që nuk e kanë vendin këtu, duhet me u marrë secili, që me pasur përmirësime për mbledhjet tjera. Në lidhje me KKSB, ky organ është këshillëdhënës, ka mbajtur tre takime në këtë gjashtëmujor, ku janë nxjerrë rekomandime të ndryshme nga ky këshill. Në emër të GP të LDK, kërkojmë nga ekzekutivi që ti zbatojnë ato rekomandime të këtij këshilli se janë rekomandime që zbatimi i tyre është në dobi të gjithë qytetarëve të komunës.

**Kryetari i Komunës:** Unë po mundohem me i përgjithësuar në pika të shkurta pyetjet e juaja. Ashtu siç e tha edhe Ardita, KKSB është këshillëdhënës që formohet në bazë të një rregulloreje të qeverisë. Me herët KKSB ka mbajtur 12 mbledhje, tani e kanë reduktuar numrin e tyre në bazë të rregullores se re në 6 mbledhje obliguese me pagesë. Këshilli i sigurisë në kuadër të tij e ka të formuar një komision autonom i cili e harton raportin dhe e bënë planifikimin vjetor, ku i përcakton edhe pikat e rendit të ditës dhe ne nuk kemi të drejtë me ia imponuar askujt për pikat e rendit të ditës. Megjithatë, ky këshill në çdo mbledhje në rend pune e ka pikën; Të ndryshme, në të cilën mund të diskutojmë tema të ndryshme. Të gjithë e kanë të drejtën e ngritjen e shqetësimeve që paraqitën, sikurse u paraqit çështja e inspektionit, do t'i paraqes një ditë në KKSB, megjithatë komisioni i ka paraparë temat e ndryshme nga të cilat dalin disa

rekomandime, prej të gjitha këtyre del çështja e sigurisë. Sa kemi arritur me i zgjidhur, është diçka tjetër, ndërkaq në kuadër të sigurisë në nivel komune, përgjegjësinë më të madhe e mban njësia e ministrisë së punëve të brendshme përmes zyrtarëve të saj. Nuk po themi që nuk kemi të meta në punën tonë që e bëjmë, megjithatë kjo është një detyrë krejt tjetër që ne faktikisht po mundohemi me iu dhënë asistencë aty ku kemi hapësirë me iu ndihmuar. U diskutuar çështja e kamerave të sigurisë, ka qenë vullneti i yni i mirë që përmes zyrës së prokurimit i kemi blerë kamerat, dhe kemi menduar se duhet me qenë faktikisht pjesë edhe ne në vëzhgim të atyre kamerave bashkë me zyrtarët policor. Ka ardhur një rregullore që na i merr këtë të drejtë dhe këto kalojnë në aset të MPB. Problemi është: Qysh me i mirëmbajtur në një aset që nuk e menaxhojmë ne? Kemi kërkuar sqarim qysh duhet ne t'i udhëheqim procedurat, për shkak të një pengese që e kemi pasur me herët. Ka qenë para 3-4 viteve një kërkesë e komandantit policor për një radar. Kemi shprehur vullnetin me ua dhënë, nuk kemi mundur me gjetur formën qysh me proceduar me prokurim, për shkak se nuk na lejon ligji. Të njëjtën situatë e kemi edhe të kamerat e sigurisë. Tash është për keqardhje që po ngritën disa tema të cilat nuk i zgjidhim ne. Mirë është me i ngritur këto shqetësime, shqetësimet të cilat ngritën janë pikërisht çështje të sigurisë. Të çështja e përdorimit të narkotikëve, nuk ka mbledhje që nuk diskutohet ky shqetësim, por sa po mundemi me arritur, ajo është diçka tjetër. Komandanti i policisë ankohet për mungesë të stafit, e kuptojmë se kërkohet çdo kund që ngritën shqetësime me qenë patrulla të policisë, por është e pamjaftueshme me mbuluar me staf. Ka raste kur kërkohen me u vrojtuar pikat 24 orë, ndërkaq janë krejt 60 zyrtarë policor, kështu e kemi kuptuar komandantin e policisë se edhe këta 60 zyrtarë nuk janë të gjithë në punë, për shkak të pushimeve vjetore e të ngjashme. Komandanti i policisë është i obliguar me raportuar në mbledhje të KKSB dhe hapësirën midis 2 mbledhjeve për ngjarjet që ndodhin, megjithatë ata bëjnë raport vjetor që e paraqesin zyrtarisht gjendjen për ngjarjet që ndodhin dhe veprimet që i kanë marrë. Megjithatë unë nuk kam të drejtë as me ndërhyrë as me ndryshuar, zvogëluar apo ekzagjeruar, a janë efikas apo jo ajo është diçka tjetër, gjendjen e shohim edhe nga këtu dhe mund të jemi të pakënaqur, këto janë mundësitë që ata raportojnë tek ne. E di se në një mbledhje ka qenë në zëvendësim të komandantit, por ka të drejtë stacioni policor në mungesë të komandantit më dërguar një zyrtar policor dhe ai raporton për gjendjen. Këto janë pikat që diskutohen, pikat tjera nuk e di qysh mundem me i futur në KKSB, përpos nëse ndokush nga këshilli i propozon në mbledhje. Unë iu kuptoj juve që po ngitni tema që janë aktuale, megjithatë i keni pa rekomandimet, thujse 90% e temave diskutohet çështja e sigurisë në forma të ndryshme. Sa po mundemi me i elaboruar dhe me i zbatuar, zbatimi është shumë i mangët në krahasim me kërkesat që dalin, për arsye që i potencova.

**z. Naim Beça:** Kërkoj falje kryetar nëse të jam drejtuar me ti, ndërkaq përgjigje nuk mora se sa persona janë arrestuar.

**Kryetari i Komunës:** MPB nuk i përgjigjet kryetarit, ata vetëm herë pas herë na raportojnë për ngjarje ditore me raporte ditore, përndryshe ne as nuk e zgjedhim as nuk e shkarkojmë komandantin e policisë. Nesër na vjen komandanti i ri i policisë fjala vjen, as nuk biem rekomandime, përpos një komunikim të mirë që kemi. Raportin vjetor e sjellin sa herë, ne mundemi me kërkuar diçka në formë mirëkuptimi, por nuk e di a kemi edhe të drejtë, për shkak se janë kompetenca të ndara.

**z. Naim Beça:** Raportet e policisë janë publike kryetar, ndërkaq ju jeni përgjegjës dhe zyrtarisht duhet me pranuar një farë raporti.

**Kryetari i Komunës:** Nëse raportet janë publike edhe ju keni qasje në to. Zyrtarisht unë nuk kam të drejtë me dhënë raportin. Unë kam të drejtë me iu njoftuar se e kanë sjellë raportin zyrtar, ndërkaq zyrtarisht kam të drejtën këtu me dhënë raportin.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ne po flasim për KKSB i cili udhëheq politika, dhe jep rekomandime në kuadër të politikave për siguri në komunë, ndërkaq çështjet që lidhen me vepra penale, mund t'i kemi si shifra, por nuk jemi kompetent, janë organet tjera.

**z. Naim Beça:** Unë i di këto çështje, kam marrë pjesë në shumë mbledhje të kësaj natyre. A janë vepra penale apo jo i vlerëson gjykata. Mbi 58 raste të paraqitura janë për raste të lehta, ndërkaq qëllimi im është, të parandalohen veprat penale të kërcënimeve, kontrabandën me lëndë narkotike, se kjo është e dyshimtë për qytetarët. Jemi prej komunave “sipas fjalëve” që më se tepërmi konsumohet droga. Policia i ka këto punë, njerëzit janë duke u arrestuar, kjo është e vërteta.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Sipas raporteve të organeve kompetente për këtë punë, gjendja nuk na del ashtu si thoni ju. MPB-departamenti i policisë që është sektor i veçantë për narkotik etj. bëjnë raporte për komunat dhe raporte vjetore. Nuk po themi që nuk ka përdorues të narkotikëve, por ne po bazohemi në informatat e organeve kompetente, ku statistikat e tyre dalin ndryshe.

**z. Naim Beça:** Vendin e parë me dënime e zëmë për prerje të druve në Kosovë. Dënimet iu shqiptohen njerëzve fukara që bartin dru, se aty raportohet. Ndërsa, prehen dru me qindra kamionë në ditë për të cilat nuk raportohet fare, normal se dalim të parët. Çështja e përdorimit të narkotikëve, nuk raportohet dhe dalim të fundit me statistika.

**z. Agim Çaka:** Problematika e narkotikëve duhet me qenë shqetësuese dhe problem për të gjithë ne, ekzekutivin, policinë. Nuk duhet me i ndarë shumë se e kujt është në kompetencë, se na kushton shumë, se kjo çështje na prekë në familje dhe aq me keq se kjo po ndodhë në bulevard në qendër të qytetit. Kjo çka po diskutohet këtu, është shumë serioze, duhet me marrë seriozisht, se me zhvilluar ky fenomen në qendër të qytetit është shumë problematike. Naimi ka të drejtë se lëvizë e i sheh, e ne që nuk i shohim, nuk d.m.th. se nuk është ashtu. Unë po i besoj Naimit dhe kam të drejtë me u shqetësuar për këtë çështje. Nuk guxojmë ne me kaluar këtë e me thënë se nuk është problem i KKSB se ky këshill merret vetëm me rekomandime. Është problem dhe është shumë më emergjente me u marrë me këtë punë, sesa me shkuar me shikuar një veturë se si është parkuar, apo me shkuar me inspektorët e komunës me shikuar orarin e lokaleve a janë duke i respektuar. Nuk është pak në secilën seancë me diskutuar këtë çështje, se është shumë serioze, se më vonë mund t'ia shohim sherrin se unë nuk e di as fëmija im dhe fëmijët e tjerëve a janë të sigurt, se kjo çështje mund të marrë përmasa e që dikur është vonë me ndalur edhe nëse duam. Mua nuk me bëjnë përshtypje fare do çështje tjera, shembull se kujt ia kanë dhënë një pronë në shfrytëzim, ndërkaq kjo që po diskutohet është shumë serioze, aq me tepër kur po diskutohet publikisht, nuk kemi nevojë as me lajmëruar se kjo seancë përcjellët, kjo është deklaratë publike sikur me thënë në TV. Policia nuk ka nevojë me prituri me denoncuar rastet, se janë këto organe të komunës këtu që po vërtetojnë këtë çështje. Këto çështje duhet me i marrë seriozisht dhe çdo vërejtje e cila epët këtu, organet relevante duhet me u marrë me to. Unë e di fuqinë time politike këtu, mirëpo e kam për obligim ndaj qytetarë që çdo fenomen me ngritur, ndërkaq a kalon apo jo ajo është çështje tjetër, nëse e shihni që e kam mirë, është mirë me vepruar. Edhe vendimet që po na i kthejnë për shkak të nuk i lejohet me ndërtuar shtëpinë në oborrin e tij se nuk është me PZHK, nuk është në rregull. Ajo çka mundem me bërë unë si anëtar i KK, obligimin tim e kryej ndaj qytetarit, ndërkaq nëse nuk ia japin lejen, është problem i komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Çështja e sigurisë kujtoj se është e vetmja temë që diskutohet pa politikë, çështje kjo e cila na prekë secilin nga ne. Është shqetësim, këto shqetësime është e vërtetë se duhet t'i ngritëm çdo ditë, besoj se organet relevante punojnë në këtë drejtim. Ne e

kemi pasur informatën e fundit ku ka pasur edhe arrestime në komunën tonë për lëndë narkotike. Ndoshta janë me kompetentë ata me dhënë vlerësim, ndërkaq ne mund t'i ngritëm si shqetësime dhe mënyrës si me ardhur deri të zgjidhja e problemit. Kjo dukuri është e evidente në gjitha komunat, edhe të ne është shqetësuese dhe duhet punohet çdo ditë në këtë drejtim nga secili që mundet me dhënë kontributin për parandalimin e kësaj dukurie, por gjithherë duke ditur se dikush tjetër është me kompetent dhe ne duhet ta ngritëm zërin të ata për këtë dukuri.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Kam pyetje për kryetarin e komunës për orarin e kujdestarisë së barnatoreve. Në bazë të ankesave të qytetarëve, përpos barnatores Riga, asnjë barnatore tjetër nuk po i përmbahet orarit. A i monitoron kush këto, se është kjo është shqetësuese e sidomos në orët e vona, ku përpos shëndetit e shqetësimeve është problematike mos me mbajtur kujdestari barnatoret.

**Kryetari i Komunës:** Kadrije, jeni duke e ngritur një temë për të cilën përgjegjësia bie në nivel qendror e jo këtu. Detyrë e nivelit qendror është me furnizuar QKMF me barna 24 orë. Nuk po akuzoj vetëm këtë qeveri, por të gjitha e kanë pasur mangësi këtë çështje. E di se jemi marrë shpesh herë me barnatoret, me mirëkuptim me tejkaluar këtë çështje. Me tregoni mua me cilin ligj mundem me ndëshkuar barnatoren se nuk punon pas orës 24:00, se kur e regjistron firmën i regjistrohesh orari i punës.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** A ka komuna rregullore për orarin e punës së barnatoreve?

**Kryetari i Komunës:** Ka rregullore, por nuk ka rregullore që mundet me të obliguar me punuar 24 orë.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Atëherë kjo po tregon se nuk po zbatohet rregullorja.

**Kryetari i Komunës:** Kur rregullorja bien në kundërshtim me ligjin, atëherë cili akt zbatohet?

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Normal se ligji zbatohet, por nëse keni vendosur rregulla në rregullore, atëherë ju si komunë duhet me iu përmbajtur rregullave dhe me zbatuar të njëjtën.

**Kryetari i Komunës:** Kemi marrë veprime në pajtim me rregulloren dhe i kemi dënuar, tani e kam problem se ligji ua mundëson mos me punuar 24 orë. Këtë problem e kemi të gjitha komunat e vogla e nuk po munden me zgjidhur. Nuk kam alternativë tjetër me zgjidhur këtë çështje, se rregullorja nuk është në harmoni me ligjin.

**z. Adnan Reka:** Ju po thoni se rregullorja nuk është në harmoni me ligjin. Rregullorja është derivat i ligjit, se mbi bazë e ligjit është nxjerrë rregullorja. Nëse ju na thoni se rregullorja është e pa vlerë, atëherë pse ka pasur nevojë me nxjerrë rregullore, të mbetet vetëm ligji. Çdo akt nënligjor, qoftë rregullore apo udhëzim administrativ, duhet me u zbatuar se është obligim. Ju duhet shikuar pjesën e juaj, i dërgoni lëndët në gjykatë, pastaj gjykata vendosë.

**Kryetari i Komunës:** E kam përsëritur disa herë, a e ke pa kontratën kolektive dhe ligjin ? Unë nuk e kam nxjerrë kontratën kolektive, por gjykata po e zbaton edhe pse është në kundërshtim me ligjin. Edhe ne e kemi nxjerrë rregulloren për hir të qytetarëve, por nuk po funksionon. Me tregoni mua, cila është forma e ndëshkimit të lokaleve pas orës 24:00 ?

**z. Adnan Reka:** Kontratën kolektive e ke zbatuar në bazë të ligjit, se neve të arsimit na i keni dhënë mjetet me përmbarues, gjithashtu ua keni dhënë mjetet me përmbarues edhe punëtorëve të shëndetësisë.

**Kryetari i Komunës:** Kontratën kolektive nuk e kam zbatuar unë, por është zbatuar me përmbarues. Me pas zbatuar unë, ishin proceduar mjetet çdo muaj, e jo pas 5 vjetëve. Me



funksionuar si duhet, as kontrata kolektive nuk ishte zbatuar, por ne po e dimë si po shkojnë punët.

**z. Agim Çaka:** Po ndërlihem me Kadrijen, barnatorja Riga ka ardhur në Kaçanik diku që 2 vjet, ndërkaq Rigoni është nga 1996. Nuk është e vërtetë që vetëm barnatorja Riga e mban kujdestarinë. Mbrëmë ajo barnatore që ka pasur me mbajtur kujdestarinë, nuk e ka mbajtur dhe unë e kam hapur barnatoren në ora 2 të natës. Janë edhe 2 barnatore tjera në shërbim sa herë që ka nevojë qytetarët. Ky orar nuk është i njëjtë në të gjitha komunat, varësisht nga specifikat. Nuk ka ligj që mundet me detyruar privatin me qenë në çdo kohë në shërbim të qytetarit, e me ardhur qytetari me marrë një barë fjala vjen, një paracetamol, se kjo na ka ndodhur. Kjo mund të organizohen në situata emergjente, kur merr vendim qeveria që krejt me u mobilizua, e jo pse nuk po mundeni me detyruar QKMF me pasur një sistem, e që nuk e ka, ndërkaq me taksa tona paguhen. Nuk jam me mbrojtur vetën se cilindo e kisha mbrojtur në këtë formë, se ai që është privat, nuk ka obligim ndaj qytetarit me tepër se ai shtetërori. Gjatë luftës barnatorja Rigoni ka qenë komplet në shërbim të ushtrisë, ka ndihmuar edhe me mjete dhe nuk përmendet asnjëherë. Kur jemi të çështja e sigurisë, kjo barnatore është thyer e demoluar 4 herë dhe askush nuk e ka ngritur si shqetësim.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Unë e respektoj punën e secilit, paralufte dhe paslufte. Në momentin që komuna ka rregullore, është e drejta ime me pyetur: A janë duke iu përmbajtur apo jo barnatoret orarit të punës ? Se a i përmbahen orarit barnatoret apo jo, janë qytetarët të cilët ankohen në këtë drejtim.

**z. Agim Çaka:** Çështjen e orarit të barnatoreve e kemi diskutuar edhe me kryetarin e komunës. Ka lëndë që kanë shkuar edhe në gjykatë. Kryetari e shpjegoj çështjen e nxjerrjes se rregullores dhe e theksoj se e njëjta bien në kundërshtim me ligjin. Për këtë çështje, ne mundemi me u ulur me debatuar, se nuk mundesh me obliguar barnatoren me punuar pas orës 24:00.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Si po shihet, e keni shndërruar debatin në bashkëbisedim. Jemi duke folur për orarin e barnatoreve a po zbatohet apo jo, a po kanë të drejtë apo jo me zbatuar rregulloren. Rregullorja ekziston, kështu që është mirë të zbatohet. Për mos zbatim ndëshkohen. Rregullorja iu ka nënshtruar vlerësimit të ligjshmërisë dhe askush nuk e ka kontestuar. Nëse është në kundërshtim me ligjin, cilado barnatore ka pasur mundësi me kontestuar rregulloren dhe ne e kishim hequr, ndoshta gjykata prapë kishte me na nxjerr të pafajshëm, por e kemi një rregullore të cilën duhet zbatuar. Diskutime tjera nuk ka, raporti është sa për njoftim, kështu që konstatohet se Kuvendi i Komunës u,

#### NJOFTUA

**Me aktivitetin gjashtëmujor janar-qershor 2022 të KKSB përmes Raportit punës së KKSB për gjashtë mujorin e parë 2022/ Lënda: 01Nr. 104/02-19514/22.**

**8. Kërkesa e MBPZHR për Anulimin e Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore PK 00729-8 ZK Bob, në vendin e quajtur "Oborr", arë e klasës gjashte (6), pronë e Blerim (Ajeti) Çaka nga fshati Bob-Kaçanik (korrigjuar PK nga 000129-8 në 00729-8);**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Theksoj se jemi të obliguar që vlerësimet negative të organit shqyrtues t'i sjelli në KK për rishqyrtim. Kemi edhe çështje tjera të cilat ende nuk i kemi vlerësimet e ligjshmërisë. Në momentin që na vijnë, nëse janë pozitiv i publikojmë, nëse janë negativ i sjellim në KK për rishqyrtim. E hapi diskutimin:

**z. Adnan Reka:** Unë mendoj se nuk duhet me shfuqizuar këtë vendim, por duhet ndryshuar dhe plotësuar, për shkak se ne si KK kemi bërë gabim, se edhe në mbledhjen paraprake ka qenë

në rend pune numri i parcelës gabim, përsëri e kemi gabim në rend pune. Nuk është i vetmi gabim se nuk është numri i parcelës i saktë, përveç të certifikata e pronës është në rregull parcela se edhe të vendimi është gabim. Kështu si rezultat i kësaj, ministria me plotë të drejtë iu ka referuar kësaj parcele gabim dhe na ka referuar me shfuqizuar vendimin, për shkak se kjo parcelë nuk ekziston. Po të kishte pasur të saktë ministria numrin e parcelës dhe zonën që është zonë urbane, nuk besoj se kishte kthyer negativ vendimin. Prandaj, ne jemi të obliguar me reaguari, se po i hymë në hak palës, po biem në kundërshtim me vetveten tonë, se me gabimet tona është dhënë vlerësimi negativ.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ministria për secilën pronë që e kërkojmë në shqyrtim të ligjshmërisë kërkon informata shtesë. Bashkë me lëndën i ka shkuar ministrisë certifikata e pronës, certifikata nuk besoj se është gabim. Ministria bazohet në certifikatë, ministria ka dhënë vlerësim negativ. Unë si kryesues e kam obligim lëndën me sjellë në KK. A e votoni apo jo, është çështje e secilit nga ne.

**z. Adnan Reka:** Ne jemi duke e shfuqizuar një vendim me vlerësim të një parcele të gabuar. Cilin vendim jemi duke e shfuqizuar, se vendimi i KK është me 000729-8, procesverbali i komisionit është me 2 zero. Unë nuk mundem me u pajtuar me logjikën që një zero plus apo minus nuk paraqet problem.

**z. Qamil Stagova:** Në bazë të kontakteve me email që kemi pasur me ministrinë, kam pasur edhe takim me zyrtarët e kësaj ministrie, vlerësimi negativ i këtij vendimi nuk ka të bëjë fare me numrat. Je duke folur me hamendje Adnan. Arsyeja e refuzimit është se prona është me PZHK, tokë bujqësore.

**z. Adnan Reka:** Ju po thoni mos i besoni dokumentit që e ka sjellë ministria, por besonim mua, se unë kam folur me ata të ministrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** A po tregohet arsyeja në vlerësim të ligjshmërisë pse me u shfuqizuar vendimi?

**z. Adnan Reka:** Po, se i referohet një parcele kadastrale që nuk ekziston. Edhe vendimi është gabim, se është me tre zero. DUKMM që tre mbledhje na i sjell me gabime propozim vendimet, me qëllim apo pa qëllim, unë nuk e di. Nëse hymë ne kompjuter dhe e kërkojmë këtë parcelë, nuk del që është pronë e Blerim Çakës.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Je gabim Adnan, se ministria ka thënë që parcela në fjalë është me destinim tokë bujqësore. Të vendimi i KK që është vlerësuar nga ministria, është në rregull parcela. E keni vendimin, shikoni. Kryesuesi në vazhdim e lexoj vlerësimin e ligjshmërisë, ndërkaq shtoj se ministria nuk iu ka referuar vendimit, në vendim është në rregull parcela.

**z. Selajdin Troni:** Drejtor, duhesh me përqendruar vëmendjen tek zyrtarët e drejtorisë tuaj që mos t'i sjellin me gabime lëndët, se kjo po na kushton. Ne po i votojmë vendimet, ndërkaq ministria po na i kthejnë të kundërligjshme dhe po duhet me marrë veprime të nevojshme me i shfuqizuar.

**z. Betim Shala:** Unë po ndërlidhem me diskutimin e Selajdin Troni që tha me i ndëshkuar zyrtarët e DUKMM të cilët kanë bërë gabime teknike. Unë nuk besoj se gabimet teknike janë bërë me qëllim, gabimet ndodhin. Problemet me kaluar vendimet e këtij lloji janë se vendimet po bien në kundërshtim me PZHK, kështu ministria po i refuzon. Ne kemi pjesë tekstuale në PZHK tonë, ku thuhet që në zona të caktuara mundesh me bërë ndërrim destinimi. Unë në takimet që kemi pasur me ministrinë, ata na thonë se nuk mund të ndërroni destinimin tokave bujqësore nëse nuk janë me PZHK. Ne iu kemi pyetur: A mundemi me shfuqizuar këtë pjesë,

pjesën tekstuale në PZHK ku thuhet, në zona të caktuara mundesh me bërë ndërrim destinimi ? Zyrtarët e MMPH a kanë thënë se nuk mundeni. Andaj, për derisa është në fuqi kjo pjesë, unë nuk jam me i shfuqizuar vendimet që na janë kthyer se nuk janë me PZHK. Edhe PZHK i ri kur të bëhet, përsëri kemi me pasur nevojë ndonjë vend me lëshuar ndonjë leje, nëse na vjen ndonjë investim, me ia ndërruar destinimin tokës. Unë jam me votuar kundër shfuqizimit të këtij vendimi.

**z. Adnan Reka:** Ne jemi duke iu referuar dy vendimeve të ndryshme me numra të ndryshëm të vlerësimi i ligjshmërisë. Përveç certifikata e pronës që është në rregull, të tjerat janë gabim.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në faqen e parë ministria e ka cekur gabim numrin e vendimit, f. 2 e ka cekur numrin mirë, në vazhdim të faqes 2 përsëri e ka cekur keq numrin e vendimit. Pasi nuk ka diskutime tjera, si përfundim i kësaj, e kthejmë edhe një herë këtë vendim në rishqyrtim të ligjshmërisë, me përmirësim të këtyre numrave që i kanë trajtuar. Kërkojmë nga DUKMM dhe sekretari e KK të japin informacione shtesë, që ministria të jetë me e vëmendshme në vlerësim të vendimeve që iu referohen, se duke i marrë kopë paste janë përcjellë gabime. MBPZHR vlerësimin e kanë dhënë, se ata për me dhënë vlerësimin kanë kërkuar edhe informata shtesë se çka parashihet me PZHK, prona është tokë bujqësore me PZHK.

**z. Qamil Stagova:** Me PZHK ajo pronë ka mbetur tokë bujqësore. Adnan po fol me hamendje.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Është e drejtë e KK a e shfuqizon vendimin apo jo. Vendim me i drejtë mendoj është të votojmë për rishqyrtim të ligjshmërisë, meqë nuk jemi të qartë në adresimin e parcelave, edhe pse është e qartë në certifikatë dhe është sipërfaqja e caktuar. Sido që të jetë, DUKMM të plotësoj kërkesën për rishqyrtim të ligjshmërisë, pasi që është dashur të jetë me dy zero e është dërguar me tre zero. Vendimi edhe një herë të kthehet në rishqyrtim të ligjshmërisë. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Me të cilin kërkohet nga MBPZHR rishqyrtimi i vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të KK Kaçanik 01nr. 06-350/02-16605/22 të datës 27.06.2022 / Lënda: 01Nr. 060/01-20506/22.**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në muajin gusht Kuvendi i Komunës është në pushim vjetor, kështu që nuk kemi ndonjë mbledhje në këtë muaj. Në shtator besoj se do t'i mbajmë 2 mbledhje, 1 në fillim të muajit, 1 në fund të muajit.

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, mbledhja i përfundoj punimet në ora 13:08. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 24 anëtarë, me arsye dolën me herët nga mbledhja, Rabije Sallahi, gjatë shqyrtimit të pikës 6, Hamide Luma gjatë shqyrtimit të pikës 7.

Procesmbajtës  
Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Murseli



REPUBLIKA E KOSOVES  
 REPUBLIKA KOSOVA  
 KOMUNA E KAÇANIKUT  
 OPSTINA KAÇANIK



Data	01-08-2022	Mbështet	KASANIĆ
Id. org.	01	104/02-22531	Shtojcë



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E BUJQESISE, PYLLTARISE DHE ZHVILLIMIT RURAL MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT Arkivi Qendror - Centralna Arhiva - Central Archive	
Nr./Br./No.	2470/2
Nr. i fq./Br. Sër./No. pg.	2+2
Data/Datum/Data:	01.08.2022
PRISHTINE - PRIŠTINA - PRISTINA	

Republika e Kosovës  
 Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
 Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja  
 Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti Ligjor/Pravni Departament/ Legal Department

Për:	Besim Ilazi, Kryetari i Komunës së Kaçanikut Kemajl Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut	
Kopje:	Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme, MAPL Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Gëzim Sahiti, Zyrtar i Lartë për Monitorim të Komunave	
Përmes:	Faton Peci, Ministër i MBPZHR-së Blerim Hasani, Sekretari i Përgjithshëm i MBPZHR-së	
Nga:	Isah Rudaku, Zy. Drejtor i Departamentit Ligjor, MBPZHR	Datë: 28.07.2022 Ref.10.231/22
Zyrtarët përgjegjës: 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Isah Rudaku, Zy. Drejtor i Departamentit Ligjor, MBPZHR	
Lënda:	Përgjigje në Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut	
Lloji i aktit:	Vendimi 01Nr.06-350/02-13415/22 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore	

I/e nderuar Kryetar,  
 I/e nderuar Kryesues,

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, më datë 12.07.2022, ka pranuar nga MAPL, Vendimin 01Nr.06-350/02-13415/22 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me datën 27.06.2022 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në ndërtimore si dhe i parashtruar për shqyrtim në MAPL, me datën 04.07.2022.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas shqyrtimit të ligjshmërisë ashtu siç parashihet në nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, bënë:

## Konfirmim për Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit

Vendimi 01Nr.06-350/02-13415/22 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me datën 27.06.2022.  
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.07.2022

Vendimi 01Nr.06-350/02-13415/22 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me datën 27.06.2022 për Parcelën Kadastrale 02302-2 zana kadastrale Kaçanik i Vjetër, në vendin e quajtur "Shoko bare kalishtë" me kulturë bujqësore Arë e klasës pestë (5), me sipërfaqe 350m<sup>2</sup>, në emër të Blerim (Qamil) Ilazi nga Kaçaniku i Vjetër nën qiramarrje për 99 vjet është në kundërshtim me Nenin 11 paragrafi 11.2 dhe paragrafi 11.4 të Ligjit Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.13/01.06.2007),), *citohet*:

Neni 11. Paragrafi 11.2. *"Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore mund të bëhet vetëm në pajtim me planin e rregullimit hapësinor dhe dispozitat tjera të përcaktuara me Ligj"*.

Neni 11 paragrafi 11.4. *"Tokës bujqësore nga neni 10.5 (a) dhe (b) nuk mund t'i ndërrohet destinimi dhe ajo nuk mund të filloj të përdoret për qëllime jobujqësore, nëse për atë rajon nuk është nxjerr plani hapësinorë, përkatësisht plani zhvillimor komunal me të cilin kësaj toke i është përcaktuar destinimi tjetër"*.

### Arsyetim

Komuna e Kaçanikut e ka të aprovuar Planin Zhvillimor Komunal me datën 28 Dhjetor 2010.

*Parcela e lartshënuar gjendet brenda Planit Zhvillimor Komunal dhe është trajtuar si tokë bujqësore andej me planin zhvillimor komunal është paraparë si tokë bujqësore (që buron nga Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor të Kosovës) është e planifikuar si tokë bujqësore, në të cilën nuk lejohet ndërtimi, pra gjendet brenda planit zhvillimor komunal, dhe rrjedhimisht nuk lejohet ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore.*

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

*Me respekt,*



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

01Nr. 06-350/02-13415/22  
Kaçanik, 27.06.2022

Në bazë nenit të nenit 11 dhe 12 lidhur me nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 10.5 (b) të Ligjit nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore, nenit 3 lidhur me nenin 6 pika 3 e Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006 për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore, të nenit 5 paragrafi 1.2 e Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor (Gazeta Zyrtare Nr. 30/23 Gusht 2013), të Propozim Vendimit të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit 06 Nr. 350/02-13415/22 (bashkëngjitur), Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 27 Qershor 2022, mori këtë:

### V E N D I M

#### **PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE, NË SIP. 350m<sup>2</sup> NË PK 02302-2 ZK KAÇANIK I VJETËR ARË E KLASËS SË 5, PRONË E BLERIM (QAMIL) ILAZI NGA KAÇANIKU I VJETËR, NËN QIRAMARRJE 99 VJET**

1. Me këtë Vendim, MIRATOHET Propozim Vendimi i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit 06 Nr.350/02-13415/22-Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, në sipërfaqe **350m<sup>2</sup>** në Parcelën Kadastrale **Nr.02302-2** Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër, në vendin e quajtur "SHOKO BARE KALISHTË" me kulturë Bujqësore **Arë e Klasës së 5**, me sipërfaqe 850 m<sup>2</sup> pronë e **Blerim (Qamil) Ilazi** nga Kaçaniku i Vjetër, nën qiramarrje 99 vjet.
2. Sipas Planit Zhvillimor Komunal, Parcela Kadastrale Nr. 02302-2, Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër, në vendin e quajtur "Shoko bare kalishtë" është me destinim Tokat Bujqësore, gjendja faktike është tokë e punuar (theksuar në procesverbalin e komisionit).
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë: Propozim Vendimi i DUKMM; Procesverbali i komisionit; Certifikata e pronës; Kopja e planit; Kërkesa e palës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
5. Zbatimi i këtij vendimi bëhet pas pagesës së taksave për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore të përcaktuara sipas Rregullores për taksat komunale
6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari.

**Me këtë Vendim njoftohen:** Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit(përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe mekanizmat tjerë relevant), Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, Drejtoria për Buxhet dhe Financa; Arkivi.





## Republika e Kosovës

Republica Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životte Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

### CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917086-02302-2

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 413--2022  
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 18.05.2022 - 11:32  
Komuna / Opština / Municipality: KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK  
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kaçanik I Vjetër / Stari Kaçanik / Kaçaniku I Vjetër  
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK

#### A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Pershkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-70917086-02302-2	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Rural	850	17-2018	14.05.2022	

#### A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
SHOKO BARE KALISHTE			14.05.2022	



**A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE**

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcesë Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcesë Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasesë Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m <sup>2</sup> ) Površina Area
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Araç/Njive/Arable	Artë E Klasesë 5/Njiva 5 Klase/5th Class Arable Land	850

**B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR**

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Liceni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postaral Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Qiramhajtje 99 vite / Pod Zakupinom 99 godine / Leasehold 99 years	Selimi Ismaili (Shefki)	1003274973	KAÇANIK I VJETËR/ STARI KAÇANIK/ KAÇANIKU I VJETËR/		Rr: "Ulpiana"	1/1	475/2022 Kontrate per shije dhe barfjen e prones nga AKP Nr. 1077, dt. 11.06.2013	18.05.2022

**I. QIRAMARRJE - ZAKUPININA - LEASEHOLD**

Pershkrimi i të drejtës së Qiramarrjes / Opis prava Zakupinina / Right of Leasehold	Emri Ime Name	Nr. personal Liceni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Afati dhe kushtet Rokovi i uslovi Terms and conditions	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Non qiramarrje 99 vjet / Pod Zakupinom 99 godine / Under lease for 99 years	ILAZI BLERIM (QAMIL)	1030802221	KAÇANIK I VJETËR/ STARI KAÇANIK/ KAÇANIKU I VJETËR/		Kontrate per barfjen e te drejtes se shfrytezimit te pajajshmerise - NENQIRAMBAJTIJE Irip nr. 4442/2018- ref nr. 1101/2018; dt. 03.08.2018	1/1	484/2018	18.05.2022





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS  
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE  
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY


KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAÇANIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kaçanik i vjetër

*Protokolli ROPP-ej = 413/2022*

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m <sup>2</sup>
P-70917086-02302-2	Parcelë / Parcela / Parcel	850



Shkalla/Razmera/Scale: 1:394

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 18.05.2022

Koha/ Vreme/ Time: 10:57:57

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo  
Kaçanik



Komuna Kaçanik  
Opština Kaçanik  
Municipal of

Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrit  
dhe Mbrojtjes së Mjedisit  
06-350/02-13415/22  
Kaçanik. 17.05.2022

Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Kaçanikut duke u bazuar Ligjin për Planifikim Hapësinor nr. 04/L-174, neni 5, paragrafi 1.2, nenparagrafi 1.2.3, ligjin për vetëqeverisje lokale :

### Propozon

Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin Komunal, që lidhur me kërkesën e z. Blerim Qamil Ilazi nga fsh.Kaçaniku i Vjetër për ndërrim destinimi të tokës nga ajo bujqësore në atë ndërtimore, të merr:

### VENDIM


Aprovohet kërkesa 06.Nr. 06-350/02-13415/22 e datës 18.05.2022 e parashtruar nga z.Blerim Qamil Ilazi nga fsh.Kaçaniku i Vjetër për lejimin e ndërrimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore në sipërfaqe prej **350m<sup>2</sup>**, në parcelën kadastrale nr.02302-2, zona kadastrale Kaçanik i Vjetër në vendin e quajtur “Shoko bare kalishtë”, me kulturë Bujqësore-arë e klasës 5, me sipërfaqe 850 m<sup>2</sup>, pronë e z. Blerim Qamil Ilazi nga fsh.Kaçaniku i Vjetër në Qiramarrje Irp 4442/2018,ref nr.1101/2018 dt.03.08.2018.

### Arsyetim

Në drejtorinë e Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka arritur kërkesa me numër 06.Nr. 06-350/02-13415/22 për ndërrimin e destinimit nga toka me kulturë bujqësore-arë i klasës 5 në tokë ndërtimore.


Komisioni për shyrtimin e kërkesave për ndërrimin e destinimit i ka rekomanduar DUKMM-së për lejimin e ndërrimit të destinimit.

Drejtori i DUKMM-së  
Qamil Stagova





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik  
Opština Kaçanik  
Municipality Kaçanik

### Komisioni për ndërrim destinimi të tokës bujqësore

DATË:	18.05.2022
REFERENCË:	06Nr.350/02-13415/22
PËR:	Drejtorinë e DUKMM-së
CC:	
PËRMES:	
NGA:	Komisioni: 1.Mustafë Loku 2.Rakip Vishi 3.Arditë Shehu
TEMA:	Proqesverbal lidhur ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në parc. 02302-2



I përpiluar më datën 18.05.2022 lidhur me kërkesën Nr. 06Nr.350/02-13415/22 të datës 18.05.2022 të parashtruar këtij komisioni nga Drejtoria e DUKMM-së, lidhur me kërkesën e paraqitur kësaj Drejtorie nga z. **Blerim Qamil Ilazi nga fsh.Kaçaniku i Vjetër**, për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore .

Me kërkesë e palës komisioni doli në vendin e ngjarjes dhe ka konstatuar siç vijon :

-Prona e propozuar për ndërrim të destinimit parcela kadastrale nr.02302-2, me kulturë arë e Kl 5. me sipërfaqe prej 850 m<sup>2</sup> e evidentuar në çerifikatë të pronës me nr.413/22 të datës 18.05.2022 dhe kopjen e planit, në Zonën kadastrale Kaçaniku i Vjetër pronë nën qiramartje 99 vjet e z. Blerim Qamil Ilazi nga fsh.Kaçaniku i Vjetër.

- verifikon se parcela në fjalë gjindet zonën kadastrale Kaçaniku i Vjetër në vendin e quajtur “ Shoko bare kalishtë ”, sipas gjendjes faktike pjesa ku parashifet për ndërrim të destinimit është tokë e punuar dhe sipas PZHK është me destinim Tokat bujqësore.

Komisioni rekomandon DUKMM-së që në parcelën e lartëcekur të lejohet ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore për pjesën parcelës kadastrale nr.02302-2 me sipërfaqe prej **350 m<sup>2</sup>**.

 REPUBLIKA E KOSOVËS	0101 - Formulari për kërkesë apo ankesë		 KACANIKU
	Drejtorati / Njesia <b>DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTRIT          DHE MBROJTJES SE MJEDISIT</b>		
<b>1</b> Informatat personale të parashtruesit të kërkesës:			<b>Mos shkruani në</b> Pranuar nga: Numri i protokollit: 06-37062-13415/22 Vendimi: po Nga: Data:
Emri dhe mbiemri <b>BLERIM IMAZI</b>		Lloji dhe numri i dokumentit identifikues <b>1030802221</b>	
Data e lindjes (dita / muaji / viti)	Adresa e vendbanimit (numri i shtëpisë/banesës, rruga, fshati/qyteti, kodi postar)		
Numri i tel. fiks	Numri i tel. mobil <b>044 591-871</b>	E-mail adresa	
<b>2</b> Selektlojin:			
Kërkesë <input type="checkbox"/>		Ankesë <input type="checkbox"/>	
<b>3</b> Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:			
<p>           Kërkesë për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, ku evidentohet arë e klosit të 5 (penti) ku kërkejt të bëhet ndërrim destinimi nën gastrëm katastrale nr 02302-2 në ZK-L Kacanik. Vjetër në sipërfaqe prej 350m<sup>2</sup>. Në këtë lokacion planifikoj të ndërtoj një objekt familjar me lokal afanist.         </p>			
<b>4</b> Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi			
Unë <b>BLERIM</b> (Emri i plotë i aplikuesit)		vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta. <b>Buy</b> (Nënshkrimi)	
*** Ju lutemi të kërkonti nga zyrtarija fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura ***			

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA E KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPŠTINA KAÇANIK

KAÇANIKU

05.08.22 vendi **KAÇANIK**

org. Numri Shtojcë

01 104/02-22532 /.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO  
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT  
Arhivi Qendror - Centralno Arhivo - Central Archive

Nr./Br.No. 2474/2

Nr. i fq./Br. Str.No. pg. 2+2

Data/Datum/Date: 01.08.2022

PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja  
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti Ligjor/Pravni Departament/ Legal Department

Për:	Besim Ilazi, Kryetari i Komunës së Kaçanikut Kemajl Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut	
Kopje:	Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme, MAPL Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Gëzim Sahiti, Zyrtar i Lartë për Monitorim të Komunave	
Përmes:	Faton Peci, Ministër i MBPZHR-së Blerim Hasani, Sekretari i Përgjithshëm i MBPZHR-së	
Nga:	Isah Rudaku, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, MBPZHR	Datë: 28.07.2022 Ref.10.229/22
Zyrtarët përgjegjës: 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Isah Rudaku, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, MBPZHR	
Lënda:	Përgjigje në Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut	
Lloji i aktit:	Vendimi 01Nr.06-350/02-12630/22 paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore	

1/e nderuar Kryetar,  
1/e nderuar Kryesues,

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, më datë 12.07.2022, ka pranuar nga MAPL, Vendimin 01Nr.06-350/02-12630/22 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me datën 27.06.2022 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në ndërtimore si dhe i parashtruar për shqyrtim në MAPL, me datën 04.07.2022.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas shqyrtimit të ligjshmërisë ashtu siç parashihet në nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, bënë:

## Konfirmim për Rishqyrtimin e Ligjshërisë së Aktit

Vendimi 01Nr.06-350/02-12630/22 paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me datën 27.06.2022.

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.07.2022

Vendimi 01Nr.06-350/02-12630/22 paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me datën 27.06.2022 për Parcelën Kadastrale P-01208-2 Sllatinë, me kulturë bujqësore Mal i klasës tretë (3), me sipërfaqe 504m<sup>2</sup> dhe livadhe iklasës tretë (3) me sipërfaqe 1702 m<sup>2</sup> në vendin e quajtur Shpati i Gjoklit, pronë e Nexhmedin (Mustafa) Elezi nga fshati Sllatinë është në kundërshtim me Nenin 11 paragrafi 11.2 dhe paragrafi 11.4 të Ligjit Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.13/01.06.2007),, *citohet*:

Neni 11. Paragrafi 11.2. *“Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore mund të bëhet vetëm në pajtim me planin e rregullimit hapësinor dhe dispozitat tjera të përcaktuara me Ligj”*.

Neni 11 paragrafi 11.4. *“Tokës bujqësore nga neni 10.5 (a) dhe (b) nuk mund t’i ndërrohet destinimi dhe ajo nuk mund të fillojë të përdoret për qëllime jobujqësore, nëse për atë rajon nuk është nxjerr plani hapësinorë, përkatësisht plani zhvillimor komunal me të cilin kësaj toke i është përcaktuar destinimi tjetër”*.

### Arsyetim

Komuna e Kaçanikut e ka të aprovuar Planin Zhvillimor Komunal me datën 28 Dhjetor 2010.

*Parcela e lartshënuar gjendet brenda Planit Zhvillimor Komunal dhe është trajtuar si tokë bujqësore andej me planin zhvillimor komunal është paraparë si tokë bujqësore (që buron nga Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor të Kosovës) është e planifikuar si tokë bujqësore, në të cilën nuk lejohet ndërtimi, pra gjendet brenda planit zhvillimor komunal, dhe rrjedhimisht nuk lejohet ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore.*

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi**.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

*Me respekt,*



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

01.Nr. 06-350/02-12630/22  
Kaçanik, 27.06.2022

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 14.1 të Ligjit Nr. 03/L-040 - Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 10.2 dhe 10.3 të Ligjit 02/L-26 –Për Tokën Bujqësore, të nenit 6.2 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006 –Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, të Propozim Vendimit të DUKMM 06 Nr. 350/02-12630//22 (bashkëngjitur), Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 27 Qershor 2022, mori këtë:

### V E N D I M P A R A P R A K

#### PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE NË PARCELËN KADASTRALE 01208-2, MAL I KLASËS 3 NË SIPËRFAQE 504m<sup>2</sup> DHE LIVADH I KLASËS 3 NË SIPËRFAQE 1722 m<sup>2</sup> NË EMËR TË NEXHMEDIN (MUSTAFA) ELEZI NGA F. SLLATINË

1. Me këtë Vendim, APROVOHET Propozim Vendimi i DUKMM 01.Nr. 06-350/02-12630/22- për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, në emër të NEXHMEDIN (Mustafa) ELEZI nga f. Sllatinë.
2. Toka me destinim bujqësor e lejuar për ndërrimin e destinimit nga pika 1. e këtij Vendimi, lejohet për sipërfaqen, **1000m<sup>2</sup>** në Parcelën Kadastrale Nr. P- **01208-2** Zona Kadastrale Sllatinë në vendin e quajtur SHPATI I GJOKLIT me Kulturë Mal i Klasës 3, me sipërfaqe 504 m<sup>2</sup>, dhe livadh i klasës 3, në sipërfaqe 1722 m<sup>2</sup>, Sipërfaqja totale e ngastrës kadastrale është 2226 m<sup>2</sup>, pronë e Nexhmedin (Mustafa) Elezi, sipas Certifikatës së pronës të lëshuar nga Zyra Kadastrale me 26.11.2021.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë: Propozim Vendimi i DUKMM, Certifikata e pronës, Kopja e Planit, Kërkesa.
4. Para marrjes së vendimit përfundimtar për ndërrimin e destinimit të tokës së përcaktuar si në pikën 2 të këtij Vendimi, do të kërkohet, Pëlqimi nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
5. Ndërrimin e destinimit të tokës së përcaktuar si në pikën 2 të këtij Vendimi, do të paguhet në procedurë administrative, sipas dispozitave në fuqi që e përcaktojnë ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari.
7. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

**Me këtë Vendim njoftohen:** Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit- përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe organet tjera relevante, Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Arkivi.





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917080-01208-2

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 06-941/01-0036405/21  
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 26.11.2021 - 13:18  
Komuna / Opština / Municipality: KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK  
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Sllatinë / Slatina / Blerana  
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-70917080-01208-2	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë private / Privatna imovina / Privately owned Land	Rural	2226	1-1978-2-2020	03.06.2020	03.06.2020

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prehivaliste - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostni adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
SHPATI GJOQLIT/SHPATI GJOQLIT/SHPATI GJOQLIT		SHPATI GJOQLIT	03.06.2020	03.06.2020



**A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE**

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenuto koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kualitet klase Quality Class	Sipërfaqja Porsina Area (m <sup>2</sup> )
1	Pjlori/shunsko/Forestry	Tokan Pjlore/shunsko zemljište/Forest	Mal I Klases 3/Suma 3 Klase/3rd Class Forest	504
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Livadhë/Livade/meadow	Livadh I Klases 3/Livada 3 Klase/3rd Class Meadow	1722

**B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR**

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licent broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo inovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	<b>Elezzi Nexhmedin (Mustafa)</b>	1004473147	SLLATINË / SLATTINA / BLERANA /		Rr "Ukë Elezzi"	1/1	321/2020 Kontrate mbi ndrejtjen fizike te paluajtshmerise I rp nr. 2255/2020; ref nr. 683/2020; dt. 10.07.2020	27.07.2020



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska  
katastarska kancelarija :

Kaçanik

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske  
jedinice : **1208-2**

Zona kadastrale / Katastarska zona :

Sllatinë

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : **Parcel**

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: **1000**

Koordinatat		
1	7514071.902	4680635.839
2	7514075.334	4680646.087
3	7514083.924	4680671.737
4	7514108.718	4680663.15
5	7514105.405	4680652.333
6	7514104.162	4680648.938
7	7514096.086	4680626.874

Sipërfaqet	
Livadh i Klasës 7	S=554 m <sup>2</sup>
Mal i Klasës 3	S=446 m <sup>2</sup>
Sipërfaqja e Përgjithshme	S=1000 m <sup>2</sup>



legjenda

- Parceja Kadastrale
- 1208-2 Nr. Parceles
- P1 Pikë e Matur
- Ndërja e Kulturave
- Pjesa për Ndririm Destinimi

Rilevoi : **Msc.Ing.Gjeo.Zekirja R. Elezi**  
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë)

Nr. i licencës / Br. licence : 17

Nënshkrimi / Potpis :

Data e rilevimit / Datum snimanja : **09.05.2022**



Aprovoi / Usvojio : \_\_\_\_\_  
(emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ ime i prezime sluzbenog lica)

Nënshkrimi / Potpis : \_\_\_\_\_

Data e aprovimit / Datum usvajanja : \_\_\_\_\_



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS  
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE  
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGJENCIA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY


KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAÇANIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Sllatinë

941-36405/2021

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m <sup>2</sup>
P-70917080-01208-2	Parcelë / Parcela / Parcel	2226



Shkalla/Razmera/Scale: 1:586

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 26.11.2021

Koha/ Vreme/ Time: 01:19:39

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoj/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska  
katastarska kancelarija :

Kaçanik

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske  
jedinice : **1208-2**

Zona kadastrale / Katastarska zona :

Sllatinë

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : **Parcel**

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: **1000**

Lumi-Lepenc



NR	Y	X
1	7514087.058	4680656.859
2	7514090.882	4680668.233
3	7514106.996	4680662.815
4	7514103.171	4680651.44

1208-2

1208-3

1208-1

1208-4

LEGJENDA

PARCELA KADASTRALE

1208-0 NR. PARCELE E VJETER

**1208-1** GJURMA E OBJEKTIT PËR LRJR NDËRTIMORE

o1010 PIKË ZYRTARE

Rilevoi : **Msc.Ing.Gjeo.Zekirja R. Elezi**  
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë)

Nr. i licencës / Br. licence : 17

Nënshkrimi / Potpis :

Data e rilevimit / Datum snimanja : **09.05.2022**




Aprovoi / Usvojio: \_\_\_\_\_

(emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ ime i prezime sluzbenog lica)

Nënshkrimi / Potpis: \_\_\_\_\_

Data e aprovimit / Datum usvajanja : \_\_\_\_\_

NR	Y	X
1	7514087.058	4680656.859
2	7514090.882	4680668.233
3	7514106.996	4680662.815
4	7514103.171	4680651.44





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska  
katastarska kancelarija :

Kaçanik

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske  
jedinice : **1208-2**

Zona kadastrale / Katastarska zona :

Sllatinë

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : **Parcel**

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: **1000**

NR	Y	X
1	7514087.058	4680656.859
2	7514090.882	4680668.233
3	7514106.996	4680662.815
4	7514103.171	4680651.44

Lumi-Lepenc



1208-2

1208-3

1208-1

1208-4

LEGJENDA

PARCELA KADASTRALE

1208-0 NR. PARCELE E VJETER

1208-1 GJURMA E OBJEKTIT PËR LRJR NDËRTIMORE

1010 PIKË ZYRTARE

Rilevoi : Msc.Ing.Gjeo.Zekirja R. Elezi  
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë)

Nr. i licencës / Br. licence : 17

Nënshkrimi / Potpis :

Data e rilevimit / Datum snimanja : 09.05.2022



Aprovoi / Usvojio: \_\_\_\_\_

(emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ ime i prezime sluzbenog lica)

Nënshkrimi / Potpis: \_\_\_\_\_

Data e aprovimit / Datum usvajanja : \_\_\_\_\_

NR	Y	X
1	7514087.058	4680656.859
2	7514090.882	4680668.233
3	7514106.996	4680662.815
4	7514103.171	4680651.44





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Skupština Opština  
Municipal Assembly  
06-350/02-12630/22

17.06.2022

Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Kaçanikut duke u bazuar në nenin 10.5 pika a e Ligjit Nr.02/L-26, për Tokën Bujqësore; në bazë të nenit 6 pika 6.3 të Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, lidhur me kërkesën 06-350/01-12630/22 për ndërrim destinimi të tokës bujqësore i

### Propozon

Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin Komunal, që lidhur me kërkesën nga z.Nexhmedin Mustafa Elezi për ndërrim destinimi të tokës nga ajo bujqësore në atë ndërtimore, të merr këtë:

### VENDIM PARAPRAK

Aprovohet kërkesa 06-350/02-12630/22 e datës 11.05.2022 e parashtruar nga z.Nexhmedin Mustafa Elezi nga fsh.Sllatinë për lejimin e ndërrimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, në parcelën kadastrale nr.P-01208-2, me kulturë mal i kl.3 me sipërfaqe prej 504m<sup>2</sup> dhe livadh i kl.3 me sipërfaqe prej 1722m<sup>2</sup>. Sipërfaqja totale e ngastrës kadastrale është 2226 m<sup>2</sup>.

Pjesa e ngastrës për ndërrim të destinimit ka sipërfaqe **1000 m<sup>2</sup>**, pronë private e z.Nexhmedin Mustafa Elezi nga fsh.Sllatinë.

### Arsyetim

Në Drejtorinë e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka arritur kërkesa me numër 06-350/02-12630/22 për ndërrimin e destinimit nga toka me kulturë Tokë Pyjore-Mal i Klasës 3 në tokë ndërtimore.

Drejtor i DUKMM-së

Qamil Stagova







REPUBLIKA E KOSOVËS

0101 - Formulari për kërkesë apo ankesë

Drejtorati / Njesia

Data

(dita / muaji / viti)



KACANIKU

1 Informatat personale të parashtruesit të kërkesës:

Emri dhe mbiemri

HEXHEMEDIN ECEZI

Lloji dhe numri i dokumentit identifikues

1004473147

Data e lindjes

19.10.1968

(dita / muaji / viti)

Adresa e vendbanimit

JULLATIN KACANIK

(numri i shtëpisë/banesës, rruga, fshati/qyteti, kodi postar)

Numri i tel. fiks

Numri i tel. mobil

044 325 987

E-mail adresa

Mos shkruani në këtë pjesë

Pranuar nga:

Numri i protokollit:

06-300/02-12630/22

Vendimi: po jo

Nga:

Data: —

2 Selektu llojin:

Kërkesë

Ankesë

3 Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:

KAM PRONEN BUJESORE DHE KËRKOJ  
QË DËJË TOKËN BUJESORE TË  
SHËNDROHET NË TOK NOËRTIMORË

4 Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi

Unë

Hexhmedin Ecezi  
(Emri i plotë i aplikuesit)

vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

(Nënshkrimi)